REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS

BIBLIOTEKA KOMBETARE TIRANË

ARKIVI SHQIPTAR

1-2

VITI XVIII 2017

ARKIVI SHQIPTAR 1-2 VITI XVIII 2017

Universal Graphic Design

ISSN 2523-6636

TIRANË, 2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS

ARKIVI SHQIPTAR

1-2

Viti XVIII 2017

ISSN 2523-6636

Tiranë, 2017

Bordi drejtues:
Kryetar: Ramë Manaj
Anëtarë: Pranvera Dibra, Shpresa Mekaj, Endrit Musaj, Skënder Hasani

Kryeredaktor: Ardit Bido

Redaktoi: Sokol Çunga
Paraqitja Grafike: Fatime Xhaferaj

Drejtoria e Përgjitshme
e Arkivave

Agjencia Shtetërore e
Arkivave të Kosovës

© Të gjitha të drejtat të rezervurara.

Revistë periodike, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Adresa e redaksisë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Rr. "Jordan Misja", Tiranë, Shqipëri.

Tel: +355 4 4541798
e-mail: dpa@albarchive.gov.al

Në kopertinë: Abetarja e Zymit, Fondi "Koleksion fondesh personale" (63), Dosja 163, fl. 12r. Autorësia i atribuohet Jak Specit (Jaku i Tush Mark Krajës), mësues në qytetin e Shkodrës. Siç thotë shënimi bashkangjitur i Lumo Skëndos, i datës 5 janar 1935, Abetarja ka qenë pronë e Luigj Shalës (Bogdanit), profesor i didaktikës në Institutin Femnor (Tiranë), të cilën e ka përdorur vetë në Prizren. Shala ia pati dhuruar Skëndos, dhe ky ia dhuron Bibliotekës Kombëtare, siç dëften edhe vula në disa prej fletëve të Abetares.

Pasqyra e lëndës

Editorial 6

Aktet e Konferencës Ndërkombëtare të Arkivistikës "Arkivat dhe puna arkivore në trevat e shqiptarëve në shek. XX – XXI":

Dr. Ardit BIDO
Sfidat e përpunimit të dokumentacionit në rrjetin arkivor kombëtar. 9

MA Ramë MANAJ
Arkivat dhe puna arkivore në Kosovë. 14

Dr. Ivan LOLI
Gjendja e arkivave dhe puna arkivore në Shqipëri nga fillimi i shek. XX deri në përfundim të Luftës II Botërore. 18

MA Luigj NREJAJ
Rëndësia e arkivave dhe dokumenteve kishtare në Kosovë nga fillimi i shek. XX deri në Luftën II Botërore. 28

Dr. Mikaela MINGA
Arkivi audio-vizual i Institutit të Antropologjisë Kulturore: përqasje studimi. 35

MA Paulin PUSHIMAJ
Arkivi i Institutit të Arkeologjisë, Tiranë – historiku dhe veprimtaria. 42

Dr. Dorian KOÇI
Koleksionet muzeore në Muzeun Historik Kombëtar dhe roli i tyre në rrëfimin e historisë. 49

Dr. Rovena VATA
Lef Nosi si mbledhës i folklorit në arkivin e IAKSA-s. 56

MA Kadri DAUTI
Fondi arkivor në fushën e mbrojtjes – trashëgimi komëbtare e vyer për mendimin politiko-ushtarak shqiptar. 63

MA Sami SALLAHU
Menaxhimi i dokumenteve dhe arkivat në Policinë e Kosovës. 69

MA Vilma NALLBANI
Tradita muzeale-arkivore në Shqipëri, ruajtja dhe evidentimi i saj: modeli i Arkivit të Kulturës Materiale në Institutin e Antropologjisë Kulturore 78

Prof. Dr. Jusuf OSMANI
Metodologjia e klasifikimit, rregullimit dhe përpunimit të fondeve dhe koleksioneve arkivore në rajon dhe në Kosovë. 84

Prof. Dr. Nevila NIKA
Nga vendruajtja në duart e studiuesit: përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve në AQSh, arritje, dështime e sfida për të ardhmen. Roli dhe përgjegjësitë e arkivistit në evidentimin e lëndës arkivore. 100

MA Sokol Çunga
Lënda arkivore përmes mjeteve të kërkimit: përgatitja *e instrumenta studiorum* si formë evidentimi, shërbimi dhe përmbushjeje e detyrimeve ligjore të arkivave. Rasti i Arkivit Qendror Shtetëror. 120

Dr. Didier LAFLEUR, Luc BROGLY
Exploring the Archives from All Sides: How Research Uses Archival Work? 126

MA Bekim ALIU
Digjitalizimi i dokumenteve arkivore në Kosovë. 129

Dr. Lorenc AGALLIU
Arkivat gojorë, mbledhja, roli dhe aplikimi i tyre. 133

MA Leonard DURMISHI
Transferimi në AShV Durrës i dokumenteve të njësive të qeverisjes vendore të shkrirë për shkak të reformës administrativo-territoriale. 145

MA Shqipe BEKTESHI-MUÇOLLI
Ruajtja dhe evidentimi i dokumenteve si hapa të nevojshëm në funksion të shërbimit dhe përmbushjes së detyrave ligjore të arkivave. 153

Phd. Rovena SAKJA GODO
Arkivat dhe të drejtat civile: nga *instrumentum regni* në mjet "pajtimi social". Funksioni aktiv i arkivistëve në transmetimin e kujtesës. 158

MA Shpresa MEKAJ
Parimet dhe përgjegjësitë e arkivistit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut (sipas rekomandimeve të ICA-së). 167

MA Fikrije BERISHA
E drejta e qasjes në dokumentet arkivore, kusht për realizimin e të drejtave të njeriut. 175

Msc. Brunilda ÇOTI
E drejta e informimit dhe e shërbimit arkivor, si avokat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. 183

Msc. Romina KALI
Zbatimi dhe realizimi i të drejtës së informimit dhe shërbimit arkivor në Bashkinë e Shkodrës, në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut. 190

Msc. Kosovar ALIJA
Menaxhimi i programeve për ruajtjen e historisë dhe vlerësimi i lëndës arkivore. 198

MA Izet ABDYLI
Biblioteka popullore dhe universitare e Kosovës nën admininistrimin serb 1990-1999 dhe dëmtimi i koleksioneve bibliotekare. 205

Ligje, vendime, rregullore 210

Vendim Nr. 360, datë 26.4.2017 për miratimim e rregullores "Për organizimin dhe funskionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave" **211**

Vendim Nr. 4, datë 19/.06. 2017, për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" **222**

Veprimtari të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për vitin 2017 249

Veprimtari të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për vitin 2017 252

Phd. Rovena SAKJA GODO
Dip. di Scienze Documentarie, Geografiche e Linguistiche
Facoltà di Lettere e Filosofia, La Sapienza

ARKIVAT DHE TË DREJTAT E NJERIUT: NGA *INSTRUMENTUM REGNI* NË MJET "PAJTIMI SOCIAL". FUNKSIONI AKTIV I ARKIVISTËVE NË TRANSMETIMIN E KUJTESËS.

Qëllimi i kumtesës është të reflektojë mbi rolin e arkivave në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shoqëritë post diktatoriale, mbi raportin mes njohjes së të Vërtetës dhe proceseve të paqtimit social, të vënë në dukje rolin potencial të akivave në promovimin e këtyre proceseve, si garantues të të drejtave të qytetarëve dhe si faktorë aktivë në ruajtjen e kujtesës kolektive të popujve.

Diskutimet mbi raportin mes arkivave dhe të drejtave të njeriut dolën vrullshëm në krye të axhendës së komunitetit arkivistik ndërkombëtar duke filluar me rënien e regjimeve ushtarake në vitet '70 (Portugali, Spanjë, Greqi e Amerikë Jugore), per t'u bërë akoma më urgjente pas shpërbërjes së regjimeve diktatoriale në Evropën Qendrore e Juglindore.

Kjo jo për faktin se përmbysjet e mëdha të shekullit XX, siç ishin rënia e fashizmit apo nazizmit, nuk paraqesin interes për çështjen e raportit mes arkivave dhe mbrojtjes së të drejtave humane[1], por sepse përvojat e 50 viteve të fundit ofrojnë pika të vlefshme referimi për politikën globale dhe kontekstet në të cilat po jetojmë në fillim të shekullit XXI[2].

Interesi për arkivat e regjimeve totalitare të 50 viteve të fundit ka të bëjë me natyrën e tyre bashkëkohore, e për këtë shkak ato marrin një rëndësi sociale dhe politike. Me kalimin në një regjim të ri politik, arkiva të cilat ishin përdorur si *instrumentum regni*, mjet shtypjeje[3], marrin një tjetër valencë, bëhen mjet i rëndësishëm në formimin e marrëdhënieve të reja shoqërore.

Për shkak të natyres së tyre bashkëkohore, arkivat e institucioneve shtypëse e diktatoriale mbartin rëndësi sociale dhe politike, dhe në këtë kontest,

[1] Në të vërtetë, në qoftë se ne do të shkojmë mbrapa ne kohe, në fillimet e shteteteve moderne, gjejmë shembullin më të madh të një institucioni shtypës, Inkuizicionin spanjoll. Sipas të gjitha gjasave, koleksionet dokumentare të këtij institucioni mund të shihen si paraardhëset e arkivave të sistemeve moderne totalitare.

[2] Richard J. Cox and David A. Wallace në: "Archives and the Public Good: Accountability and Records in Modern Society" Quorum Books, 2002, nënvizojnë faktin se në dekadat e fundit arkivat janë bëerë elemente kyçe në formësimin e botës sonë. Sipas tyre *"It was the power of the documents as sources to scrutinize actions which was their principal characteristic"*.

[3] Sipas Michel Foucault, "Records are active instruments of social control used by society and its organizational structures and institutions to marginalize non-conformists. Archives should not be seen as neutral products of processes and transactions, but as intentional recordings that serve those in control", shih: Michel Foucault në: *The Archaeology of Knowledge*, New York, 1972. Jacques Derrida, "And the theory of archive is a theory of this institutionalization, that is to say of the law, of the right which authorises it. This right imposes or supposes a bundle of limits which all have a history, a deconstructible history, and to the deconstruction of which psychoanalysis has not been foreign, to say the least", shih: Jacques Derrida, *Archive Fever: A Freudian Impression*, University of Chicago Press, 1996.

raporti mes arkivave dhe të drejtave të njeriut i tejkalon kufijtë e disiplinës arkivistike dhe merr konturet e një problemi social.

Përmbysjet e regjimeve diktatoriale, përveç problemit të mbijetesës dhe ruajtjes së arkivave si burim studimor historik, nxorën në pah edhe problemin e rehabilitimit të viktimave dhe të të persekutuarve, të rehabilitimit të kujtesës, të së vertetës dhe drejtësisë.

Roli i arkivave dhe i dokumentacionit që ruanin ato ishte i domosdoshëm për afirmimin e të drejtave individuale (rehabilitim, amnisti, dëmshpërblim, pensione, kthim i pronave), për tutelimin e të drejtave kolektive, për procesin e paqtimit social të popujve, përveç funksionit të tyre si provë në proceset penale e civile.

Përtej vlerësimeve që i përkasin hapësirës kombëtare të secilit prej vendeve ish diktatoriale, duhet vlerësuar edhe përmasa ndërkombëtare në raportin mes arkivave dhe të drejtave të njeriut, që i referohet konceptit të drejtësisë universale. I formuluar në Konventën kundër genocidit në periudhën e Gjyqit të Nurembergut, ky koncept është kthyer në një praktikë gjyqësore si rezultat i krijimit të Gjykatave për krimet në ish Jugosllavi, në Ruanda apo i masave të gjykatësit Garzon kundër Pinochet-it, e të tjera raste në vende të ndryshme të botës, deri në krijimin e Gjykatës Ndërkombetare të Krimeve.

Ky globalizëm i drejtësisë universale ka përforcuar rekomandimin se arkivat e shërbimeve të inteligjencës duhet të mbrohen si pjesë e trashëgimisë sonë botërore. Ky lloj dokumentacioni duhet të vihet në dispozicion të publikut, për të ruajtur kujtesën kolektive të secilit popull si pjesë e kujtesës universale. Sipas këtij konceptimi, përgjegjësia për rujatjen e këtyre arkivave i kalon kufijtë kombëtarë, ashtu si hetimi dhe dënimi i shkeljes së të drejtave njerëzore është një çështje që i intereson të gjithë komunitetit ndërkombëtar.

Në nivel ndërkombëtar ka një korpus të konsoliduar studimesh e rekomandimesh që identifikojnë si detyrim të Shtetit ruajtjen e arkivave që dëshmojnë shkeljen e të drejtave të njeriut, duke lejuar e lehtësuar konsultimin e tyre.

Një instrument i rëndesishëm për të kuptuar impaktin e dokumentacionit arkivistik në mbrojtjen e ruajtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut është raporti i Komisionit për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara "*Principles for the protection and promotion of human rights and for preventing the granting of immunity*" (Parime për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe për parandalimin e dhënies së imunitetit - 17 prill 1998).

Në mesin e viteve '90, Komisioni për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara, i kërkoi juristit francez, Louis Joinet, të identifikonte një korpus parimesh, të cilave duhej t'u referoheshin Shtetet për të shmangur mundësinë që shkeljet e të drejtave të njeriut të mbeteshin pa përgjegjësi, të padënuara.

Në pjesën hyrëse të parimeve, të publikuara në 1997, Joinet formuloi përkufizimin e së drejtës për të njohur;

Parimi 1:

- ***"right to know" – e drejta për të njohur,*** *nuk është vetëm një e drejtë e viktimave apo e të afërmve të tyre, që mund të cilësohet edhe si e drejta për të vërtetën* ***"right to the truth".*** *E drejta për të njohur është një e drejtë kolektive, që na lejon të nxjerrim mësime nga historia, për të mos lejuar që shkelje të tilla të përsëriten në të ardhmen".*

Nga kjo buron parimi 2:

- ***"duty to record – detyra për të krijuar dokumente",*** *detyra që u vihet Shteteve për të mbrojtur veten nga akuza e rishkrimit të historisë apo e mohimit të krimeve të diktaturave. Këtë parim Shtetet duhet ta marrin përsipër si garanci kundër deformimeve perverse të historisë, ato që sot quajmë negacionizëm dhe revizionizëm…"*

Përkufizimin e së drejtës për të njohur Joinet e shihte të lidhur drejtpërdrejt me domosdoshmërinë për të ruajtur arkivat, për të cilat parimi 13 i raportit shprehet keshtu:

- *"E drejta për të njohur nënkupton që arkivat duhet të ruhen. Duhen parashikuar parametra teknike e sanksione penale për të parandaluar çdo lloj humbjeje, shkatërrimi, fshehjeje apo falsifikimi të arkivave, veçanërisht nëse kanë qëllim të garantojnë e të favorizojnë fajtorët e shkeljeve të të drejtave të njeriut"*

Parimet e formuluara nga Joinet nxitnin Shtetet që të inventarizonin arkivat dhe të lehtësonin aksesin e përdoruesve, si dhe inkurajonin, gjithashtu, bashkëpunimin arkivor ndërkombëtar, me qëllim kërkimin e së vërtetës.

Në vitin 2005, Komisioni i OKB-së për të drejtat e njeriut publikoi një përditësim të këtyre parimeve (të rishikuara nga juristja amerikane Diane Orentlicher) duke ritheksuar detyrën e Shteteve për ruajtjen dhe për garantimin e "së drejtës së pamohueshme për të vërtetën"

> *"Cdo popull ka të drejtën e pamohueshme për njohjen e së vërtetës mbi ngjarje të së kaluarës, që kanë lidhje me krime të urryera, mbi* **rrethanat dhe arsyet** *që kanë shërbyer si bazë për kryerjen e këtyre krimeve."*

Varianti i përditësuar i parimeve ka rivërtetuar domosdoshmërinë për të lehtësuar aksesin në arkiva, jo vetëm për t'u dhënë mundësi viktimave dhe të afërmve të tyre për të vënë në vend të drejtat e tyre, si dhe të akuzuarve të mbrohen, por *"aksesi i ketyre arkivave duhet të lehtësohet edhe në interes të kërkimit historik"* (duke përjashtuar, sigurisht, kufizimet për ruajtjen e privatësisë).

Kombet e Bashkuara kanë ritheksuar parime të ngjashme edhe në Rezolutën e Këshillit për të drejtat e njeriut më 2009 (United Nation General Assembly, Human Rights Council. Twelfth session. A/HRC/RES/12/12.

Resolution adopted by the Human Rights Council: 12/12. Right to the truth).

Një tjetër instrument që ofron parime dhe udhëzime në administrimin e arkivave të shërbimeve të sigurimit shtetëror të ish regjimeve shtypëse është edhe "Archival Policies in the protection of human rights" (Politikat arkivore në dobi të mbrojtjes së të drejtave të njeriut), raport i përbashkët i Unesco dhe International Council on Archives (1995), me autor Antonio González Quintana, i përditësuar me 2009.

Këto instrumente u përpunuan në kuadrin e një fushate gjithëpërfshirëse në mbështetje të demokracive të reja në vendet ish komuniste, për të cilat hapja e arkivave nënkuptonte:

së pari, që të gjithë arkivat, sidomos ato partiake, të ruajtura në arkivat publike, të administroheshin në përputhje me ligjet e sistemeve të reja demokratike;

- së dyti, të garantohej akses i barabartë për të gjithë përdoruesit;
- së treti, garantimi i aksesit të materialit arkivistik të viteve mes fundit të Luftës së Parë Botërore dhe rënies së regjimeve diktatoriale, i cili dyshohet të ketë qenë subjekt i manipulimeve dhe falsifikimeve nga autoritetet komuniste.

Këto vende u përballën edhe me një problem tjetër: <u>impaktin e vërshimit të dokumentacionit të shërbimeve sekrete shtetërore në procesin e tranzicionit politik.</u>

Ky dokumentacion nuk ishte dhe nuk është ende thjesht një instrument në kërkimin e fajtorëve në proceset e rehabilitimit e dëmshpërblimit të viktimave, por është instrument politik jashtëzakonisht i fuqishëm, që shpeshherë është përdorur në mënyrë të njëanshme për përfitime politike. Rasti më i fundit janë akuzat për Les Valesën si bashkëpunëtor i shërbimeve sekrete polake.

Për më tepër, kishte dhe ende ka elementë të interesuar në zhdukjen e dokumentacionit të prodhuar gjatë periudhës diktatoriale, si p.sh., ish agjentë të regjimit apo anëtarë të aparateve drejtuese; por edhe ajo pjesë e popullsisë që ishte bërë palë me lidershipin e periudhës së tranzicionit, sipas të cilit e shkuara paraqiste një peshë shumë të madhe për demokracitë e brishta post diktatoriale; kishte edhe ndër ata që konsideronin rrezikun e përdorimit të dokumentacionit për qëllime shantazhi apo hakmarrjeje; ata që konsideronin mbrojtjen e privatësisë më të rëndësishme se kërkimin e së vërtetës dhe të përgjegjësive penale e morale.

*Ësht*ë fakt i pranuar tashmë vështirësia e përcaktimit të kritereve për konsultimin e këtij dokumentacioni, pikërisht sepse interesat dhe subjektet e përfshira janë shumë të ndryshme mes tyre, dhe sepse nevoja dhe detyrimet ligjore mund të krijojnë përplasje mes tyre.

Dilema arkiv i mbyllur vs.arkiv i hapur shoqërohet me dilemën akoma më dramatike: të ruash apo të asgjësosh dokumentacionin, kur nevoja për të garantuar pacenueshmërinë e sferës private arrin deri në propozimin e shkatërrimit të plotë dhe përfundimtar të çdo gjurme dokumentare.

Shembull i vështirësisë së gjetjes së zgjidhjeve për problemin e barazpeshimit mes së drejtës së individit për privatësi dhe së drejtës kolektive

për të vërtetën, kur në diskutim vendosen të dhënat personale, është debati i zhvilluar në Gjermani në lidhje me 180 km linear të dokumentacionit të Stasi-t. Në debat u përfshinë pozicione të papajtueshme me njëra tjetrën: kërkesa e individëve të përfshirë *të cilët kërkonin shkatërrimin e dokumentacinit q*ë lidhej me ta; nevoja politike për pajtim kombëtar, pavarësisht përçarjes së shkaktuar nga bashkëpunimi i 1/3 të popullsisë me shërbimet sekrete.

Sigurisht, edhe eksperienca shqiptare në trajtimin e arkivave të Sigurimit të Shtetit është domethënëse për vështirësitë që paraqet kjo çështje, sidomos po të kemi parasysh që roli i arkivave të shërbimeve të inteligjencës në vendet në tranzicion ka qenë dhe ende është thelbësor në përcaktimin e politikave të lustracionit apo vetingut, të cilat janë bërë tashmë mjete pune e pika referimi në aktivitetin e përditshëm të arkivistëve.

Megjithëse debati mbi hapjen, apo mos hapjen e arkivave të periudhës diktatoriale zakonisht ka si objekt dokumentacionin e prodhuar nga shërbimet sekrete, këto nuk janë të vetmet burime dokumentare për studimin e dhunës së ushtruar nga diktaturat. Nga përvoja e vendeve që kanë përjetuar regjime diktatoriale, janë identifikuar katër grupe institucionesh që gjatë aktivitetit të tyre kanë prodhuar dokumentacion për abuzime masive të të drejtave të njeriut:

1. Arkivat e institucioneve që ushtronin dhunën, si p.sh., arkivat e Sigurimit të Shtetit, arkivat e Gjykatave Speciale, arkivat e burgjeve, të kampeve të përqendrimit, arkivat ushtarake dhe arkivat gjyqësore.
2. Arkivat e organizatave që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të njohura ndryshe si "shoqëria civile", si p.sh., arkivat e organizatave në mbrojtje të viktimave, por edhe arkivat e partive, sindikatave, organizatave opozitare brenda apo jashtë vendit, e organizatave fetare, të shoqatave e juristëve[4].
3. Arkivat e institucioneve të krijuara pas luftërave apo rënies së diktaturave, me qëllim gjykimin e përgjegjësve të dhunimit të të drejtave njerëzore apo me qëllim rehabilitimin dhe dëmshpërblimin e viktimave, por edhe organizata karakteristike të periudhave të tranzicionit, si p.sh., Komisionet e së Vërtetës (Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin në Afrikën e Jugut).
4. Më së fundi, dokumentacion të dobishëm për studimin e dhunës në vendet post-diktatoriale, mund të gjendet edhe në arkivat e përgjithshme publike. Ato shpesh ruajnë prova të dhunimit të të drejtave njerëzore, për vetë faktin se ishte detyrim i tyre institucional ruajtja e dokumentacionit të prodhuar nga institucionet publike. Në nivel *teorik* kjo përbën garancinë më të mirë që dokumentat e rëndësishme për interesin e përgjithshëm të ruhen e të bëhen të përdorueshme. Dokumentacioni arkivor bëhet, kështu, spontanisht pasqyrë e shoqërisë në të cilën u krijua, qoftë kjo edhe një shoqëri diktatoriale.

[4] Organizata "Memento" në Estoni për kërkimin e fakteve për qytetarët, viktima të shtypjes, u bazua në materiale të konservuara në arkivat publike.

Ku ruhet dokumentacioni që dëshmon shtypjen dhe abuzimet e regjimeve diktatoriale? Eksperienca ndërkombëtare është e shumëllojshme. Shpeshherë është zgjedhur të krijohen institucione publike autonome *ad hoc*, si në Gjermani e në Guatemala, ku dokumentacioni ruhet në selinë e ish institucioneve të dhunës. Por ky dokumentacion mund të ruhet edhe në arkiva privatë që mund të ruajnë arkiva e dokumentacion me prejardhje të ndryshme, në vetë arkivat kombëtare, si në rastin e Rusisë dhe të Brazilit, apo edhe në vetë entet që kanë trashëguar kompetencat gjatë tranzicionit politik.

Në pjesën më të madhe të rasteve destinacioni përfundimtar i këtyre agregatëve dokumentarë nuk është i rastësishëm, por kushtëzohet nga vlera e dëshmive që ofrojnë dhe nga mënyra se si i ka përdorur apo synon t'i përdorë shoqëria. Në qoftë se dokumentet u besohen gjykatave apo administratave arkivore, është shenjë se atyre po u jepet një vlerë juridike, në rastin e parë apo kulturore, në rastin e dytë. Në rast se dokumentacioni i besohet një pale të tretë, siç mund të jenë institucione të krijuara *ad hoc*, mund të jetë shenjë e vështirësisë për të pajtuar të drejta në kontrast me njëra-tjetrën (e drejta e informimit me të drejtën e privatësisë).

Por, përveç funksionit të tyre politik e social, arkivat e dhunës paraqesin interes në studimin e strukturës dhe organizimit të vetë institucionit apo fondkrijuesit. Arkivat e regjimeve të dhunshme diktatoriale, pavarësisht kohës dhe vendit ku janë zhvilluar, paraqesin disa karakteristika të përbashkëta.

- Mania dokumentare: çdo gjë është e dokumentuar me një kujdes gati patologjik për detajet më të vogla[5].
- Grumbullim i stërmadh informacioni që mbulonte çdo aspekt të shoqërisë dhe burokratizim i skajshëm i terrorit[6].
- Organizim efikas i arkivave[7].

Nestor Norberto Cendon, anëtar i skuadrave të shërbimeve sekrete argjentinase, të specializuara në shtypjen e opozitës politike, në dëshminë e tij përpara CONADEP[8] dhe në dëshmine e tij para organeve gjyqësore, solli një përshkrim të përmbajtjes së dosjeve të shërbimeve sekrete:

- Urdhër kërkimi ose mbledhje; urdhër gjurmimi; urdhër përgjimi postar dhe telefonik. Kërkesa për precedentët e personit të mbikëqyrur drejtuar shërbimeve të spiunazhit të policisë federale, të ushtrisë, të forcave ajrore, të marinës, të shtetit, të policive të provincave, të burgjeve federale, të prefekturës portuale, të xhandarmërise kombëtare. Kërkesa për informacione për personin e hetuar u drejtohej edhe zyrave elektorale,

[5] V. Harris, "The archives and secrecy in South Africa: A personal perspective", in Janus 1999.

[6] Disa shifra të administratave të policive sekrete të vendeve të Lindjes, pa marrë në konsideratë bashkëpunetorët e jashtëm: Rumani – 25.000; Çekosllovaki – 20.000; Republika Demokratike Gjermane – 90.000; Bullgari 6.000 - 9.000; Hungari – 2.000.

[7] Sipas Ernest Posner, suksesi fillestar i Gjermanisë naziste kishte të bënte me faktin se hyri në me sistemin më të mirë arkivistik. Shih Linda Giuva, Stefano Vitali, Isabella Zanni Rosiello, *Il potere degli archivi: Usi del passato e difesa dei diritti nella società contemporanea,* Milano, Mondadori 2007, faqe 170.

[8] Komisioni Kombëtar për Zhdukjen e Personave në Argjentinë.

gjendjes civile e çdo zyre të administratës shtetërore. Skeda të detajuara mbi çdo lëvizje të të dyshuarit e më pas të të burgosurve me emrin e vërtetë, pseudonimin dhe emrat e kodifikuar. I gjithë ky material më pas mikrofilmohej.

Përmbysjet sociale, politike e historike mund të transformojnë vlerën dhe domethënien e dokumentacioni arkivor, që lind për nevojat praktike të institucionit apo entit represiv, por për shkak të përmbysjes së sistemit në cilin u prodhua, merr domethënie të reja e të paparashikueshme. Nga instrument abuzimi, domentacioni bëhet mbrojtës i të drejtave, nga mjet kontrolli social, në mjet i aktivizmit demokratik.

Arkivat fshehin dhe shpalosin padrejtësi; ndihmojnë të shkruajnë historinë e fitimtarëve në fillim, dhe të viktimave më pas. Këto luhajtje domethëniesh e përdorimesh nuk janë të rastësishme, por janë të kushtëzuara nga konteksti politik e kulturor, në të cilin arkivat përmbushin funksionet e tyre, dhe që përcakton edhe kërkesat sociale e nevojat të cilave duhet t'u pergjigjen.

Mirëpo, do të ishte gabim po t'i shihnim arkivat si spektatorë pasivë në këto procese. Transmetimi i kujtesës nuk është kurrë një operacion neutral, sepse, me kalimin e kohës është objekt "manipulimesh dhe montazhesh" që kushtëzojnë qarkullimin dhe cilësinë e informacionit dhe të njohjes.

Në kontekstet e reja shoqërore e politike post-diktatoriale, arkivave dhe arkivistëve u kërkohet jo vetëm të *përmbushin funksionin e tyre primar n*ë ruajtjen e dokumentacionit për qëllime studimore e historike, por edhe të luajnë një rol aktiv në konsolidimin e sistemeve demokratike, duke u bërë ndërmjetësues të ushtrimit të të drejtave individuale dhe kolektive të garantuara nga demokracia[9].

Profesioni ynë nuk mund të mos marrë pjesë në çështjen e të drejtave të njeriut. Arkivat në shoqërinë demokratike i shërbejnë popullit. Dokumenti i ruajtur, i kuptueshëm në shtrirje dhe që dokumenton të gjithë shoqërinë, i arritshëm për të gjithë në mënyrë të barabartë, përbën themelin e pazëvendësueshëm të qeverisjes së mbështetur në prova. Vetëm duke kuptuar ndershmërisht shoqëritë që kemi trashëguar dhe që vijojmë t'i ndërtojmë, duke kuptuar fuqitë dhe dobësitë e tyre, mund të përballemi efektivisht me sfidat e shek. XXI. "Our profession cannot be absent from the issue of human rights. Archives in a democratic society serve the people. The preserved record, comprehensive in scope and documenting all of society, equally accessible to all, constitutes the irreplaceable foundation of evidence based governance. Only through an honest understanding of the societies we have inherited and which we continue to build, their strengths and weaknesses, can we effectively address the challenges of the 21st Century" –

Ian Wilson, President of the ICA[10].

[9] "…armamentario in difesa dei diritti..." shih Brenneke, *"Archivistica, contributo alla teoria ed alla storia archivistica europea"*, Milano, Giuffre 1968, fq. 173.

[10] Antonio Gonzalez-Quintana, *The Management Of The Archives Of The State Security Services Of Former Repressive Regimes,* UNESCO, ICA, 2009, fq. 8.

Sipas këtij konceptimi, bashkëbiseduesit e arkivistëve nuk janë vetëm historianët dhe studiuesit, por qytetarët dhe administratorët publikë dhe, në përgjithësi, e gjithë shoqëria civile e publike; fusha e veprimit nuk është vetëm dokumentacioni historik, por edhe ai në fazën aktive.

Me përmbysjen e sistemeve diktatoriale në vendet ish komuniste, ndryshuan edhe proceset e ballafaqimit me të shkuarën, si dhe aktorët që i drejtonin këto procese. Cilët janë sot aktorët që drejtojnë proceset e ballafaqimit me të shkuarën?

Sipas Pierre Nora në "Reason for the current upsuge in memory": *"…në një botë ku kishte një histori kolektive dhe shumë kujtesë individuale, historianët ushtronin kontroll ekskluziv mbi të shkuarën. Ndërsa sot ky është një rol që tashmë historiani e ndan me gjykatësin, dëshmitarin okular, mediat dhe ligjvënësin".*

Cili është roli i arkivistëve në një botë kur transmetimi i kujtesës së *përvojës diktatoriale* është kaq i larmishëm dhe sheh të *përfshir*ë kaq shumë aktorë/autorë: historianë, dëshmitarë okularë, gazetarë, kineastë, shkrimtarë?

Arkivistët janë ndërmjetës mes dokumentacionit arkivistik dhe përdoruesve. Ata tashmë s'mund te kufizohen thjesht në ruajtjen materiale të dokumentacionit arkivor, por duhet të ndërmarrin një rol aktiv në trasmetimin e kujtesës së dhunës diktatoriale dhe dhunimit të të drejtave të njeriut.

Janë ata që kanë përgatitjen e duhur teknike, gjëqë i bën të vetëdijshëm se vlera dëshmuese e dokumenteve mund të ndikohet nga mënyra me të cilën trajtohen. Marrë jashtë kontekstit arkivor, shumica e dokumenteve që dëshmojnë shkelje të të drejtave, shtypjen apo dhunën, mund të humbasin një pjesë të madhe të vlerës së tyre.

Duke patur njohje integrale të të gjithë kompleksit dokumentar dhe kontekstit arkivistik, arkivistët kanë një pozicion të privilegjuar në transmetimin e kujtesës, të japin çelesa aksesi edhe për përdoruesit më pak ekspertë, kanë instrumentet dhe aftësitë teknike të sjellin në dritë edhe ato historitë e vogla, më pak të dukshme, që ndoshta nuk i interesojnë historisë *mainstream*, por që janë të domosdoshme *për kujtes*ën tonë të përbashkët.

*"…ë*shtë *e lehtë* *t*ë *shkruash historin*ë *t*ënde *kur ke kujtes*ë *t*ë *dob*ët*…"*
Arthur Schnitzler

Bibliografi:

Antonio Gonzalez Quintana, *The Management Of The Archives Of The State Security Services Of Former Repressive Regimes,* Paris, UNESCO – ICA, 2009.

Adolf Brenneke, *"Archivistica, contributo alla teoria ed alla storia archivistica europea"*, Milano, Giuffre 1968.

Verne Harris, *The archives and secrecy in South Africa: A personal perspective,* in Janus 1999

International Council On Archives, Human Rights Working Group, *Basic Principles On The Role Of Archivists And Records Managers In Support Of Human Rights,* A working document of the International Council on Archives, September 2016.

http://www.ica.org/en/basic-principles-role-archivists-and-records-managers-support-human-rights

Linda Giuva, Stefano Vitali e Isabella Zanni Rosiello, *Il potere degli archivi: Usi del passato e difesa dei diritti nella società contemporanea,* Milano, Mondadori 2007.

Ludmila Da Silva Catela, Elisabeth Jelin, *Los archivos de la represion: documentos, memoria y verdad*, Madrid, Siglo 21 de Espana Editores, 2002.

Richard J. Cox, David A Wallace, *"Archives and the Public Good: Accountability and Records in Modern Society"* Quorum Books 2002.

United Nation General Assembly, Human Rights Council, Twelfth session, A/HRC/RES/12/12. *Resolution adopted by the Human Rights Council*: 12/12.

United Nations Commission On Human Rights. Sub-Commission On Prevention Of Discrimination And Protection Of Minorities. Forty-ninth session. E/CN.4/Sub.2/1997/20/Rev.1, *The Administration of Justice and the Human Rights of Detainees. Question of the impunity of perpetrators of human rights violations (civil and political).*